

V E N D I M
Nr.10, datë 14.1.1999

PËR DOKUMENTACIONIN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Familjet, që pretendojnë për ndihmë ekonomike, duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a. Deklaratën Tip për gjendjen social-ekonomike të familjes, e cila plotësohet nga kryefamiljari një herë në vit.

b. Deklaratën specifike Tip që plotësohet, detyrimisht, çdo muaj.

c. Certifikatën e gjendjes familjare, ku shënohet data e regjistrimit në regjistrin themeltar dhe vendbanimi i mëparshëm.

ç. Dokumentin e pronësisë të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (kadastra) për tokat bujqësore, duke shënuar sipërfaqen dhe kategorinë e tokës.

Deklaratat Tip përgatiten sipas modeleve të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. Administratorët e zyrave të ndihmës ekonomike, në bashki a komunë, janë të detyruar të marrin, zyrtarisht, nëpërmjet listave, informacionin e nevojshëm nga institucionet e mëposhtme:

-Zyra e punës

-Zyra e tatim-taksave

-Zyra e sigurimeve shoqërore

-Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (hipoteka)

-Zyra e regjistrimit të automjeteve

-Degët e bankave

-Seksionet pranë bashkive (urbanistika, tregu i lirë etj.)

-Inspektorati i punës

a. Këto institucione, si dhe sipas rastit institucione të tjera, janë të detyruara që brenda 10 ditëve nga marrja e listave të njoftojnë zyrtarisht zyrat e ndihmës ekonomike në bashki a komunë.

b. Administratorët shoqëror kanë të drejtë që, sa herë lind nevoja, të marrin informacion nga këto institucione.

c. Institucionet e mësipërme janë të detyruara të njoftojnë çdo muaj zyrtarisht administratorët e zyrave të ndihmës ekonomike në bashki a komuna, për të gjitha ndryshimet që ndodhin në regjistrat e tyre përkatës.

3. Në rastet kur familja përfituese rikthehet në skemën e ndihmës ekonomike, pas një periudhe ndërprerjeje të pagesës deri në një muaj, ajo duhet të riplotësojë dokumentacionin e plotë.

4. Për kushte të veçanta socia-lekonomike dhe shëndetësore të familjes, administratorët shoqërorë duhet të kërkojnë dokumente shtesë, plotësuese, të cilat përcaktohen me udhëzimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.304, datë 30.6.1994 “Për dokumentacionin e përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe pika 3 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.605, datë 30.10.1995 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko